

Tipare të kulturës politike në Shqipërinë post-komuniste

*Matilda Pajo**

Abstrakti

Studimi i kulturës politike të një vendi luan një rol shpjegues mbi kuptimin e dinamikës së sistemit politik, lindjes dhe konsolidimit të institucioneve demokratike në shoqëri të caktuara. Qëllimi i këtij punimi është të argumentojë se kultura politike në Shqipërinë post-komuniste nuk është kongruente me institucionet demokratike të vendit, pasi kjo kulturë politike ka trashëguar ndikime të shumta gjatë sistemit totalitar komunist, për gati pesëdekada. Ndikimet dhe pasojat e totalitarizmit mbeten ende të patrajuara nga shoqëria shqiptare, për këtë arsye është me interes të veçantë hulumtimi i këtyre temave. Përmes analizimit të komponentëve të kulturës politike mund të shpjegojmë fazën e konsolidimit demokratik të një shoqërie, nivelin e pjesëmarrjes qytetare në demokraci dhe performancën institucionale, në këtë rast të Shqipërisë. Supozimi bazë i këtij punimi është se kultura politike post-komuniste në Shqipëri e ka frenuar procesin e konsolidimit demokratik në vend, përgjatë një procesi të papërfunduar të tranzicionit, nga sistemi totalitar në sistemin e shteteve liberal-demokratike. Metodologjia e përdorur në këtë punim është e natyrës cilësore, me qasje interpretative e analitike. Kuadri teorik i punimit mbi bazën e të cilit interpretohet, analizohet dhe tipizohet kultura politike postkomuniste shqiptare mbështetet tek teorikët si Almond, Verba, Inglehart e të tjerë.

Fjalë kyç: *kulturë politike, totalitarizëm, demokraci, tranzicion, sistem politik.*

* Matilda Pajo, PhD.Candidate në Universitetin e Tiranës. Kolegji AAB. Email: matilda.pajo.sallova@gmail.com.

Hyrje

Analiza e tipareve të kulturës politike në Shqipërinë post-komuniste ndihmon të kuptojmë dinamikën e sistemit politik shqiptar gjatë fazës të tranzicionit dhe “hedh dritë” mbi rolin determinues që kultura politike ka në proceset demokratizuese. Koncepti i kulturës politike u përdor për herë të parë nga Gabriel Almond në mesin e viteve 1950¹ dhe më pas u paraqit si studim i zgjeruar në librin “The civic culture”² të autorëve Almond dhe Verba. Megjithatë, kurioziteti dhe interesi për të studiuar ndryshimet kombëtare në politikë është më i hershëm, që prej filozofëve antikë grek si Herodoti e deri te filozofë e studiues si Tokëvil³, Fromm⁴, Inglehart⁵ e shumë të tjerë. Nga ana tjetër, studimet e kulturës politike shqiptare në etapa të caktuara historike janë mjaft të limituara, ashtu sikurse mungojnë punimet shkencore për ndikimet dhe pasojat e totalitarizmit shqiptar në periudhën e tranzicionit.

Nëse shtetet rajonale të dala nga sisteme diktatoriale si Rumania dhe Bullgaria kanë hapur drejtime të veçanta universitare për studim, institute dhe publikime të mirëfillta për komunizmin, shkaqet dhe pasojat e tij, në Shqipëri këto studime

¹ Gabriel Almond, “Comparative political systems”, (*The journal of Politics*, vol. 18, no.3, gusht 1956, Southern Political Science Association), f.. 391-409.

² Gabriel Almond & Sidney Verba, *The civic culture*, (Princeton University Press, 1963)

³ Shih: Aleksis Dë Tokvilë, *Mbi demokracinë në Amerikë*, (Dukagjini, Pejë, 1998)

⁴ Shih: Erich Fromm, *Njeriu për vete*, (Phoenix, Tiranë, 2003) dhe Erich Fromm, *Arratisje nga liria*, (Plejad, Tiranë, 2011).

⁵ Shih: Ronald Inglehart dhe Christian Welzel, *Modernization, cultural change and democracy: The human development sequence*, (Cambridge University Press, New York, 2005) dhe Ronald Inglehart, “East European value system in global perspective” në *Democracy and Political Culture in Eastern Europe*, redaktuar nga Hans- Dieter Klingemann, Dieter Fuchs, dhe Jan Zielonka, (Routledge, Oxon, 2006)

kanë munguar. Njohja e fakteve, shkaqeve, pasojave dhe trashëgimisë komuniste ende është interes për Shqipërinë dhe shoqërinë e saj. Në aspektin formal Shqipëria vendosi funksionimin e sistemit demokratik politik mbi norma, standarde dhe vlera shoqërore të përfshirjes dhe jo të përjashtimit sikurse kishte ekzistuar më parë. Institucionet nga ana formale ishin demokratike, por a u demokratizua vërtetë individi shqiptar? A u detotalizua shoqëria shqiptare?

Supozimi bazë i këtij punimi është se mungesa e kongruencës midis kulturës politike dhe institucioneve demokratike ka luajtur një rol frenues dhe pengues për rrugën e Shqipërisë drejt demokratizimit. Kultura politike e Shqipërisë post-komuniste nuk bazohet në parime, vlera dhe qëndrime demokratike për shkak se është ngjizur në një pjesë të mirë të saj gjatë totalitarizmit gati pesë dekadësh. Për të demonstruar këtë supozim do të trajtohen aspektet teorike të kulturës politike, komponentët kryesorë të saj, faktorët që ndërtojnë kulturën politike të një vendi dhe tipat kryesorë të kulturës politike të njohur në literaturën e shkencave politike e shoqërore. Gjithashtu, punimi fokusohet te tiparet e kulturës politike në Shqipërinë postkomuniste si rast studimor. Metodologjia e përdorur në këtë studim ndërthur analizën teorike me atë empirike për të mbështetur hipotezën e ngritur. Për këtë arsye, ky punim mbështetet në burime të ndryshme si: literatura mbi studimet e kulturës politike, të totalitarizmit dhe proceseve demokratizuese; raporte të instituteve dhe organizatave shqiptare dhe ndërkombëtare mbi progresin e Shqipërisë dhe nivelin e demokracisë në vend si dhe në një sërë analizash, intervistash dhe anketash të realizuara nga shoqëria civile mbi perceptimet e qytetarëve dhe qëndrimin e tyre mbi sistemin politik.

Kultura politike si determinuese e proceseve demokratike

Studimet e kulturës politike të një vendi janë në një masë të mirë studime të cilat kanë si qëllim njohjen dhe studimin e sistemit politik të një shoqërie. Interesi për të studiuar rrënjët e ndryshimeve kombëtare e shtetërore në politikë është i hershëm në shkencat shoqërore. Studimet mbi kulturën politike kanë të bëjnë me kushtimin e rëndësisë së duhurdisa karakteristikave të veçanta të sferës politike në një shoqëri të caktuar. Sipas Gabriel Almond një nga studiuesit eminent të kulturës politike dhe shkencës politike të krahasuar, sistemi politik është pikë së pari një sistem i veprimit, ndaj është me interes të studiohen normat dhe institucionet pasi ato ndikojnë sjelljet dhe besimet në një shoqëri⁶. Thelbi i studimeve mbi kulturën politike është hulumtimi i marrëdhënieve midis etapave të ndryshme të socializimit, procesit final të socializimit dhe të modeleve dominante të sjelljes në kulturën politike. Por, çfarë mund të shpjegojë kultura politike, veçanërisht duke pasur parasysh objektin e studimit që është Shqipëria e post-komunizmit?

- *Nivelin e konsolidimit demokratik në një shoqëri*
- *Nivelin e pjesëmarrjes në demokraci dhe*
- *Performancën institucionale*

Çdo sistem politik ngjizet në një model të veçantë të orientimit ndaj veprimit politik dhe Gabriel Almond i referohet kësaj marrëdhënie si kulturë politike. Në formimin e kulturës politike të një vendi ndikojnë disa faktorë ndër të cilët më të rëndësishmit janë: 1. ngjarjet madhore historike, 2. proceset e shtrira gjatë në kohë (long dure) dhe 3. socializimi. Agjentët socializues në

⁶Gabriel Almond, *Comparative political systems*, (Journal of Politics, vol. 18, no. 3, Gusht 1956,) f. 391-409.

procesin socializues politik, më të rëndësishëm janë: së pari familja dhe së dyti elitat dhe kulturat submasive.

Sipas Almond duhen bërë dy saktësime kur flasim për kulturë politike:

“së pari: kultura politike nuk koincidon me një sistem politik të dhënë apo me shoqërinë, pasi modelet e orientimit ndaj politikës shtrihen përtej kufijve të sistemit politik dhe së dyti: kultura politike nuk është e njëjta gjë si kultura e përgjithshme e një vendi edhe pse është e lidhur me këtë të fundit. Orientimi politik përfshin: aftësitë konjitive (njohëse), intelektin, përshtatjen ndaj situatave të jashtme, por edhe vlerat dhe parimet standarde të kulturës së përgjithshme, pra është një pjesë e diferencuar e kulturës dhe ka si të thuash dozën e vet të autonomisë”⁷.

Nën drejtimin e komunistëve shoqëria shqiptare u kthye në një tabula rasa gati për t’u shkruar nga sistemi. Pra, gjatë regjimit diktatorial u promovua një sistem vlerash dhe i besimit i cili ishte në pajtim me doktrinën komuniste. Kultura politike e shoqërisë shqiptare ende është në një pjesë të konsiderueshme e formësuar gjatë regjimit totalitar dhe si e tillë është një kulturë jodemokratike. Kultura politike e një kombi dhe e një shoqërie mund të lehtësojë marrëdhëniet demokratike e politike midis shtetit dhe shoqërisë ose mund t’i ngadalësojë ato. Ndërtimi i kulturës politike gjatë sistemit totalitar u bë përmes linjës zyrtare të propagandës dhe u përdorën shtypi, emisionet radiofonike, filmat, dokumentarët, letërsia, arti, muzika për të krijuar një sistem vlerash dhe normativ në pajtim me kulturën totalitare komuniste⁸. Ndërkaq, ruajta dhe promovimi i sistemit të vlerave

⁷Ibid, f. 396.

⁸ Shih mbi rolin e organizatave të masës dhe mjetet e propagandës në shtetet totalitare: Claude Lefort, *La complicazione, al fondo della questione comunista*, (Eleuthera, Milano, 2000) dhe Claude Lefort, *The political forms of modern society*, (MIT Press, Cambridge, Massachusetts, 1986), ndërsa për rolin dhe

dhe i normave të kulturës komuniste u realizua përmes unioneve, organizatave të cilat ishin zgjatime të Partisë së Punës e kështu me radhë⁹.

Sistemet totalitare në logjikën e funksionimit të tyre kanë ruajtjen e pushtetit dhe kjo mund të ndodhte vetëm me një popullsi që ndante dhe pajtohej me vlerat dhe parimet e diktaturës totalitare. Për këtë arsye, diktatura totalitare u infiltrua edhe në agjentët socializues tejet të rëndësishëm si familja. Familja është hapësira e parë socializuese për fëmijën, kontakti i parë me botën, por familja në regjimet totalitare ishte koncept ideologjik dhe thelbësor në forcimin e pushtetit. Duhet theksuar se agjentët socializues në procesin socializues politik janë dy: familja dhe elitat e kulturat submasive. Pas gati pesë dekadave nën totalitarizëm a ka formësuar familja shqiptare vlera demokratike? Po të njëjtën pyetje mund ta shtrojmë dhe për elitat. Përgjigja e këtyre pyetjeve mund të na ndihmojë ta kuptojmë stagnimin e Shqipërisë me demokratizimin.

Termi “kulturë politike” u përdor për herë të parë nga Gabriel Almond¹⁰ dhe më pas u përpunua më gjerësisht nga Gabriel Almond dhe Sidney Verba në librin “The civic culture”¹¹. Studimi i Almond dhe Verba përpiqej të gjente relacionin sesi individët ndikojnë sistemin politik dhe e kundërta. “Më specifikisht, ‘kultura politike’ i referohet specifikisht modelit të qëndrimeve individuale dhe orientimeve drejt politikës në mesin

qëllimet e organizatave të masës dhe mjeteve të propagandës në Shqipërinë totalitare, shih: Afrim Krasniqi, *Partitë Politike në Shqipëri 1920-2006*, (Eurorilindja, Tiranë, 2006).

⁹Ibid.

¹⁰ Gabriel Almond, “Comparative political systems”, (*The journal of Politics*, vol. 18, no.3, gusht 1956, Southern Political Science Association), f. 391-409.

¹¹ Gabriel Almond & Sidney Verba, *The civic culture*, (Princeton University Press, 1963)

e anëtarëve të sistemit politik”¹². Pra, kultura politike është një set i orientimeve kundrejt një seti specifik të objekteve dhe proceseve sociale.

Almond dhe Verba përdorin termin ‘kulturë’ politike pasi i angazhon të ndërthurin, kombinojnë dhe studiojnë kuadrin konceptual të disa disiplinave shkencore si qasjet antropologjike, sociologjike dhe psikologjike¹³. Kultura politike shihet nga Almond dhe Verba si një formë lidhëse midis makro dhe mikro politikës në një shoqëri të caktuar. Po ashtu kultura politike ka interes në gjetjen e karakteristikave të veçanta të një sfare politike. Literatura e kulturës politike përpiket të shpjegojë dinamikat e caktuara të institucioneve politike dhe në mënyrë të veçantë lindjen dhe konsolidimin e demokracisë.

Kultura politike duke ju referuar Fjalorit Politik të Oksfordit përfshin “qëndrimet, bindjet dhe vlerat, në të cilat mbështetet veprimtaria e një sistemi politik të dhënë. Këto duhej të përfshinin njohjen dhe aftësinë e shfrytëzimit të sistemit politik, ndjenjat emocionale pozitive dhe negative ndaj tij dhe gjykimet vlerësuese mbi sistemin.”¹⁴ Ndërkaq, Lawrence C. Mayer et.al, e shpjegon konceptin e kulturës politike si “predispozicione psikologjike apo orientime mendore që predispozicionojnë individët në një sistem politik të reagojnë ndaj objekteve politike në mënyra të caktuara”¹⁵. Kultura politike është aspekti i sistemit politik modern i cili ndikohet më së shumti prej ndodhive dhe përjetimeve të së kaluarës së një kombi.¹⁶ Pra, kultura politike ndikohet mjaft nga përvojat e së kaluarës të një shoqërie dhe si e

¹² Gabriel Almond & Sidney Verba, *The civic culture*, (Princeton University Press, 1963) f. 18.

¹³ Ibid f. 19.

¹⁴ Ian McLean & Alex McMillan, *Oxford-Concise dictionary of politics*, (Oxford University Press) f. 409

¹⁵ Laurence C. Mayer. Et.al, *Politika krahasuese*, (Ora Botime, Tirana, 2003) f. 14.

¹⁶ Ibid

tillë kultura politike e Shqipërisë post- komuniste është ndikuar prej të kaluarës së saj diktatoriale.

Në sistemet totalitare promovohet një sistem i vlerave që janë absolute dhe çdo individ apo grup kolektiv duhet të orientohet në aktivitetet e tyre në bazë të këtij sistemi vlerash dominant. Modeli i sistemit të vlerave luan një rol total duke ndikuar fizikisht, moralisht dhe spiritualisht në mënyrën se si individët sillen. Pra, ky sistem i vlerave absolute formëson dhe rregullon përmes kodit të tij, organizimin shoqëror privat dhe kolektiv. Përmes këtij roli, modeli dominues shoqëror luan një ndikim total fizik e shpirtëror në sjelljet e individëve¹⁷. Një prej aspekteve më negative të totalitarizmit, e përjetuar kjo dhe nga shoqëria shqiptare, nuk është rritja e pranisë së politikës në shoqëri sesa “metamorfoza e vetë shoqërisë në të cilat politika pushon së ekzistuari si një sferë e ndarë”¹⁸.

Objektivi parësor i regjimit totalitar ishte transformimi i raporteve sociale e njerëzore në mënyrë që “gjithçka të jetë e organizuar, gjithçka të jetë materie për organizimin e partisë”¹⁹. Shkatërrimi i raporteve sociale ekzistuese nga integrimi i individëve në tërësinë e organizatave cenoi raportet spontane njerëzore. Frika nga individë që dëgjonin, raportonin dhe mbanin shënim çdo bisedë solli si pasojë krijimin e marrëdhënieve artificiale njerëzore ku askush nuk thoshte atë që mendonte. Mjafton që t’i drejtohem rastit të Shqipërisë, për të parë pasojat e mëdha që kjo la në shoqërinë shqiptare. Ende, edhe pas 26 viteve të vendosjes së regjimit demokratik, në Shqipëri shoqëria civilenuk është fuqizuar, reagimet publike të qytetarëve për çdo çështje publike, sociale e ekonomike është topitur. Integrimi i individëve në rrjetet e organizatave kultivuan

¹⁷ Claude Lefort, *The political forms of modern democracy*, ed. John. B. Thompson (MIT PRESS: Cambridge, Massachusetts, 1986) f. 79

¹⁸ Ibid f. 79.

¹⁹ Ibid f. 91.

pasivitete dhe uniformitet, topitje dhe përgjumje të veprimit dhe mendimit, tipare ende mbizotëruese edhe sot në shoqërinë shqiptare.

Rënia e sistemit komunist u paralajmërua nga zhvillimet politike e shoqërore në rajon, kolapsi i komunizmit në Rumani e Bullgari ndikoi në nxitjen për ndryshime politike në Shqipëri. Shqipëria është vendi i fundit ku ra sistemi totalitar komunist në Evropë, ndërsa kalimi i pushtetit nga komunistët tek partia e parë opozitare e Shqipërisë (PD) ndodhi përmes një tranzicioni paqësor. E megjithatë, sot pas 25 viteve prej zgjedhjeve të pluraliste Shqipëria ende nuk është përballur me trashëgiminë komuniste dhe pasojat e saj. Ligji mbi hapjen e dosjeve të ish-bashkëpunësorëve të diktaturës nuk është miratuar, nuk ka ende dëmshpërblime për të burgosurit politik, çështja e kthimit të pronave ish të përndjekurve është e pazgjidhur. Në shkollat fillore dhe të mesme në Shqipëri nuk ka informim mbi natyrën e sistemit totalitar që ka sunduar shoqërinë shqiptare për pesë dekada, së fundmi për këtë arsye është arritur një marrëveshje mes Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit me Ministrinë e Arsimit, për të mbajtur ligjërata informuese mbi krimet, pasojat dhe gjenocidin e realizuar nga diktatura komuniste²⁰.

Por cilat janë aspektet kryesore që përbëjnë kulturën politike të një kombi? Sipas Lawrence C. Mayer et.al vetitë e kulturës politike janë: “qëndrimet ndaj autoritetit; besimet apo konceptimet rreth së vërtetës; një metodë logjike apo pragmatike për marrjen e vendimeve; ndjenjat e simpatisë, ftohjes, refuzimit, besimit apo mosbesimit; njohuritë dhe informacioni dhe vlerat

²⁰ Shih, Periudha Komuniste, mësim në gjimnaze, marrë nga: <http://www.standard.al/2016/12/15/periudha-komuniste-mesim-ne-gjimnaze-agron-tufa-nuk-do-bejme-propagande/>, parë për herë të fundit më 24 prill 2017)

themelore.”²¹ Kështu, kultura politike me të gjithë aspektet e saj të lartpërmendura është mjaft e rëndësishme pasi ndikon në vetë produktin politik e demokratik të një vendi. Në rastet kur kultura politike përputhet me sistemin politik të një shoqërie a të një kombi, ky sistem politik funksionon më mirë dhe për pasojë ka një legjitimitet të shëndoshë. Ndërkohë, kur kultura politike e një vendi nuk përputhet me sistemin politik të atij vendi atëherë sistemi politik do ta ketë vështirësi të përshtatet me shoqërinë apo kombin dhe e kundërta, për pasojë sistemi politik mund të shihet me mosbesim apo të ketë mungesë legjitimiteti. Nga studiues të ndryshëm është konstatuar se “qeverisja e efektshme lyp që orientimi ndaj pushtetit që kërkon formati kushtetues duhet “të përputhet” pak a shumë me orientimin përkatësnë kulturën e atij kombi”²². Ndaj, sipas Laurence C. Mayer et.al: “në ato pjesë të botës ku bindja e verbër ndaj autoritetit është normë shoqërore, njerëzit mund ta kenë të vështirë të përshtaten me idenë se duhet ta bëjnë qeverinë përgjegjëse për veprimet e saj politike.”²³

Ronald Inglehart në një punim mbi “East European value systems in global perspective”, shkruan se pozita që një shoqëri mban në indeksin e mbijetesës, vetë-përmbushjes është e lidhur ngushtë me nivelin e demokracisë së një vendi²⁴. Shtetet ish-komuniste të dala nga ndikimi i ish BRSS-së edhe pse në vitet 1991 nisën proceset e tranzicionit demokratik, një pjesë e mirë

²¹ Laurence C. Mayer. Et.al, *Politika krahasuese*, (Ora Botime, Tirana, 2003), f. 14.

²²Herry Eckstein, “A theory of stable democracy”, në *Divisions and Cohesion in democracy: A study of Norway* dhe Herry Eckstein, “Authority relations and government performance: A theoretical Framework,” *Comparative Political Studies*, vëllimi 2, nr.3 (269-362), cituar në Laurence C. Mayer et.al, *Politikat krahasuese*, (Ora Botime, Tiranë, 2003) f. 14

²³ Laurence C. Mayer et. al, *Politikat Krahasuese*, (Ora Botime, Tiranë, 2003) f. 14

²⁴ Ronald Inglehart, “East European value system in global prespective” në *Democracy and Political Culture in Eastern Europe*, redaktuar nga Hans- Dieter Klingemann, Dieter Fuchs, dheJan Zielonka, (Routledge, Oxon, 2006)

prej tyre nuk janë shtete të pasura, të drejtuara nga post-materializmi apo demokratike, madje kanë ecur në drejtimin e kundërt²⁵. Sipas Inglehart, vendosja e institucioneve demokratike nuk do të thotë domosdoshmërisht që do të prodhojë një kulturë që ta mbështesë demokracinë dhe vlerat e vetë-përmbushjes²⁶. Duket se zhvillimi ekonomik nxit ndryshimet sociale dhe kulturore duke i afruar individët me vlerat e vetë-përmbushjes dhe profilit post-materialist.

Në shtetet ish-komuniste Inglehart vëren se mbizotërojnë vlerat e mbijetesës dhe se vlerat e vetë-përmbushjes kanë nivele mjaft të ulëta dhe kjo ka të bëjë me natyrën e sistemit komunist dhe më pas me kolapsin e tij²⁷.

II. Tipare të kulturës politike në Shqipërinë postkomuniste

Raporti midis qytetarit dhe publikesë është një raport i zhdrejtë dhe instrumental. Qytetari shqiptar nuk e sheh publikën si diçka të veten edhe pse publikja është në pronësi të të gjithë qytetarëve në mënyrë të përbashkët dhe e asnjë qytetari në mënyrë individuale. Sipas autorëve hungarezë Tomash, Feher dhe Heler të cilët kanë studiuar pasojat e totalitarizmit dhe botën komuniste, ky është një tipar i përbashkët i shoqërive të dala nga diktatura. Qytetari shqiptar i dalë nga një sistem i gjatë totalitar i ndrydhjes dhe i shtypjes përjetoi një “tërheqje disidente nga politika dhe një eksod nga qyteti”²⁸.

Në këtë punim, paraqitja e raportit midis qytetarit, politikës dhe qytetit (polisit) mbështetet në konceptet e filozofisë së

²⁵ Ibid

²⁶ Ibid

²⁷ Ibid

²⁸ Gashpar Tomash, Ferenc Feher, Agnesh Heler, *Filozofia dhe tranzicioni*, (Arbri, Tiranë, 1989) f. 32.

Hannah Arendt. Kur Arendt flet për veprim i referohet veprimtarisë në polis, për përfshirjen e qytetarëve në punët e përbashkëta publike. Kjo veprimtari si e tillë nuk mund të bëhet vetëm, por vetëm me të tjerë. Mbrojtja dhe mbarëvajtja e polisit nuk varet prej një individi të vetëm, por prej të gjithë individëve. Pjesëmarrja e njerëzve në punët e polisit, vendit (lagjes, qytetit, shtetit, kombit) është ajo që përcakton dhe masën e ndërgjegjësimit qytetar dhe demokratizimit. Megjithatë, qytetari shqiptar gjatë periudhës së tranzicionit shoqëror, ekonomik e kulturor nuk ka qenë një qytetar pjesëmarrës, pra nuk ka ndikuar për të ndryshuar elitat dhesistemin politik. Mungesa e respektit ndaj institucioneve, parja e idesë së shoqërisë civile si një shoqëri “private” kanë sjellë në shoqërinë shqiptare një lloj kulti të “privates”²⁹.

Reduktimi i sferës publike dhe lartësimi i privates ka sjellë krijimin e një raporti instrumental të qytetarit me të përbashkëtën, sferën publike. Ku mbështetet ky pretendim? Së pari, nëqëndrimin pasiv dhe indiferent të qytetarit dhe shoqërisë shqiptare kundrejt zhvillimeve politike, sociale, ekonomike e kulturore. Së dyti, në mungesën e angazhimit politik nga ana e qytetarëve, qoftë për të artikuluar kërkesat e tyre ndaj elitës dhe sistemit politik, apo për ta ndikuar sistemin politik. Studime mbi angazhim politik të qytetarëve shqiptarë bëhen në mënyre të përvitshme nga organizata dhe institute të ndryshme, të huaja e shqiptare. Sipas Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim qytetarët shqiptarë e lidhin angazhimin politik vetëm me përfshirjen në parti politike. Të pyetur në anketimet e realizuara nga Instituti mbi ndikimin që ata si qytetarë mendojnë se kanë në sistemin politik, qytetarët janë përgjigjur: 72.8% që nuk kanë aspak ndikim dhe pushtet për vendin në tërësi dhe 59.4% mendojnë se nuk kanë aspak ndikim dhe pushtet në zonën e tyre

²⁹ Ibid.

elektorale³⁰. Pra, qytetari shqiptar mendon se nuk ka pushtet në sferën publike dhe se nuk ka ndikim në sistemin politik të vendit, rrjedhojë e këtij perceptimi është tëhuajësimi i rolit të qytetarit në shoqëri dhe ndjesia e këtij të fundit se sistemi politik dhe elitat politike mund të funksionojnë pa pjesëmarrjen e tij në proceset shoqërore dhe politike.

Ndërkaq, të pyetur mbi arsytet që mund ta shtynjë të bëhet pjesë e një partie politike, qytetarët përgjigjen kështu: rreth 71.9% e qytetarëve përfshihen për të ndihmuar familjen dhe miqtë (pra, për të punësuar në baza familjare dhe miqësore) dhe 58.5 % për interesa personale³¹. Siç na dëshmojnë dhe këto rezultate qytetari shqiptar e sheh publikën përmes një logjike instrumentaliste dhe ku interesi personal dhe lidhjet familjare janë më të rëndësishme sesa aktivizmi politik për hir të interesit të përgjithshëm qytetar. Duken se këto rezultate pajtohen me konstatimet e Gashpar Tomash, i cili vë në dukje se pas jetesës për dekada të tëra nën një diktaturë totalitare ku çdo gjë mistifikohet me vendosjen e sistemit të ri politik (demokracinë), njerëzit përqaftuan privaten: “njerëzore është privatja, kërkesat universaliste abstrakte shiheshin vetëm si një formë e disa individëve për të arritur tek pushteti”³².

Në raportin midis qytetarit dhe shtetit, qytetari është dyshues ndaj shtetit. Po aq sa mosbesues ndaj institucioneve dhe sistemit politik. Ky argument mbështetet në studime dhe anketime të ndryshme sikurse janë studimet e përvitshme të realizuara nga IDM-ja (Instituti për Ndërmjetësim dhe Zhvillim) dhe anketimet

³⁰ Instituti për demokraci dhe ndërmjetësim (IDM), *Analizë e angazhimit politik në Shqipëri-2016* (marrë nga [https://www.ndi.org/sites/default/files/IDM%20Audit%20of%20Political%20Engagement%20\(Shqip\).pdf](https://www.ndi.org/sites/default/files/IDM%20Audit%20of%20Political%20Engagement%20(Shqip).pdf), parë për herë të fundit më 24 prill 2017)

³¹ Ibid

³² Gashpar Tomash, Ferenc Feher, Agnesh Heler, *Filozofia dhe tranzicioni*, (Arbri, Tiranë, 1989) f. 46

e realizuara me studentët e Universitetit të Tiranës, dega e Shkencave Politike nën drejtimin e Profesor Aleksandër Kocanit, që shprehin mosbesimin e lartë të shqiptarëve në institucionet publike³³. Qytetarët e shoqërive ish-totalitare arritën në konstatimin se “politika është e keqe”³⁴, evidencë që e gjejmë edhe në shoqërinë shqiptare post-komuniste. Në pyetjen se sa të kënaqur janë me punën aktuale të parlamentit, qeverisë dhe opozitës qytetarët shqiptarë përgjigjen se: 57.5% e qytetarëve janë të pakënaqur me punën e qeverisë, 56.8% janë të pakënaqur me punën e kuvendit dhe 69.7 % janë të pakënaqur me punën e opozitës³⁵. Pra, qytetarët shqiptarë janë të pakënaqur ndaj sistemit politik në tërësi. Interesantështë dhe niveli tepër i lartë i pakënaqësisë me opozitën, pra qytetarët jo vetëm janë të pakënaqur dhe mosbesues me punën e qeverisë dhe parlamentit, por nuk kanë besim që opozita si një forcë potenciale për të marrë pushtetin do të sjellë ndryshimin e kërkuar. Ndërkaq, në përcëpimet për funksionimin e parlamentit shqiptar të dhënat janë po kaq të zymta: 42% mendojnë se parlamenti nuk e vendos qeverinë para përgjegjësisë, 48% e qytetarëve deklarohen se diskutimet në parlament nuk kanë lidhje me çështje që e ndikojnë atë, 59% nuk bien dakord që deputetët janë përfaqësues të respektuar të shoqërisë, 56 % deklarojnë që nuk është institucion transparent dhe 50 % mohojnë që parlamenti është i hapur ndaj qytetarëve³⁶. Po ashtu, pjesa më e madhe e të anketuarve kanë perceptimin se deputetët nuk i

³³ Aleksandër Kocani, *Hulumtimi i sistemit të vlerave në Republikën e Shqipërisë në periudhën postkomuniste*, (AU, Tiranë 2013)

³⁴ GashparTomash, Ferenc Feher, Agnesh Heler, *Filozofia dhe tranzicioni*, (Arbri, Tiranë, 1989) f. 47.

³⁵ Instituti për demokraci dhe ndërmjetësim (IDM) *Analizë e angazhimit politik në Shqipëri- 2016*, (marrë nga [https://www.ndi.org/sites/default/files/IDM%20Audit%20of%20Political%20Engagement%20\(Shqip\).pdf](https://www.ndi.org/sites/default/files/IDM%20Audit%20of%20Political%20Engagement%20(Shqip).pdf), parë për herë të fundit më 24 prill 2017)

³⁶ Ibid

adresojnë çështjet që qytetarëve u interesojnë në organet kompetente³⁷. Besimin më të lartë shqiptarët e kanë tek institucionet ndërkombëtare si NATO (74%) dhe BE (72 %), ndërkaq 1 në 3 qytetarë i beson qeverisë, më pak të besuara janë sistemi gjyqësor (80 %) dhe partitë politike (79%)³⁸. Mbi 50 % e të anketuarve nuk kanë besim në institucionet publike³⁹.

Tipar tjetër i kulturës politike në Shqipërinë post-komuniste është niveli i lartë i konfliktualitetit. Elementi i konfliktit vihet re te komunikimi institucional midis partive, në kuvend, në median vizive dhe të shkruar e kështu me radhë. Konflikti si tipar është i kudondodhur dhe pamundëson ndërtimin e një komunikimi të bazuar në respektimin e tjetrit. Konflikti reflektohet në marrëdhënien e ndërtuar midis vetes dhe tjetrit në shoqërinë shqiptare, “tjetri” shihej me dyshim, i ndryshëm dhe si pasojë armik. Ky element u kultivua nga koha në kohë si pasojë e të kaluarës së gjatë nën sundime autoritare dhe jodemokratike. Gjatë regjimit komunist nga “tjetri” duhej ruajtur, ai mund të ishte spiun, armik i klasës, një njeri që mund të vinte në rrezik sigurinë tënde ndaj dhe siç shpreheshin shpesh përjetuesit e atyre viteve “ndryshe flitej dhe ndryshe mendohej”. Pra, komunikimi u bë formal dhe i gënjeshtërt, mosbesues ndaj tjetrit. Çfarë tregon tipari i konfliktualitetit në sistemin politik? Së pari qëklasa politike nuk ka kuptim (koncept) mbi demokracinë dhe së dyti që partitë kryesore shqiptare edhe pse funksionojnë dhe garojnë në një sistem politik pluralit, nuk e pranojnë opozitën si koncept dhe “tjetrin” si një oponent.

Tranzicioni i papërfunduar shqiptar ka njohur një sërë konfliktesh me dimensione të ndryshme. Sipas Artan Fugës flasim për konflikte “midis grupeve të ndryshme shoqërore,

³⁷ Ibid

³⁸ Instituti për demokraci dhe ndërmjetësim (IDM), *Sondazhi i opinionit publik-besimi në qeveri* (BE dhe UNDP, Tiranë, dhjetor 2015)

³⁹ Ibid

konfliktet ndërindividuale, ashtu edhe ato brenda vetvetes sëçdo individi”⁴⁰, dhe duhen kërkuar rrënjët shoqërore të konfliktit përgjatë tranzicionit. Njohësi i sistemeve politike Afrim Krasniqi ndalet te konflikti politik midis partive kryesore, sipas tij “konflikti politik i vazhdueshëm midis opozitës dhe pozitës prodhon kriza politike dhe sociale”⁴¹. Konsensusi i munguar politik përçështjet me rëndësi madhore për ecurinë e vendit e ka penguar Shqipërinë për të përmbushur kriteret dhe standardet e vendosura nga Bashkimi Evropian për integrimin në BE. Prej 27 viteve tranzicioni vendi mbahet peng i krizave politike të krijuara nga niveli i lartë i konfliktualitetit midis partive kryesore politike dhe në pjesën më të madhe të tyre marrëveshjet janë arritur me ndërhyrjen e aktorëve ndërkombëtarë në proces. Aktualisht Shqipëria ndodhet në një tjetër krizë politike me opozitën e cila deklaron që nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të këtij viti dhe pozitën e cila deklaron se do t’i mbajë zgjedhjet pa opozitën. Konfliktualiteti dhe mungesa e tolerancës kanë cenuar vazhdimisht gjatë fazës së tranzicionit stabilitetin e vendit.

Qytetari shqiptar është pragmatist dhe i përket një sistemi vlerash të profilit materialist. Ai, qytetari, nuk beson ende në vlerat post-materialiste si vlerat e lirisë, barazisë, demokracisë e kështu me radhë. Qytetari shqiptar ka një qasje pragmatike ndaj botës që e rrethon, shoqërisë në të cilën jeton dhe shtetin e tij. Ronald Inglehart ka konstatuar se niveli që një shoqëri mban në indeksin e mbijetesës dhe vetë-përmbushjes është e lidhur ngushtë me nivelin e demokracisë së një vendi⁴². Pra, sa më pranë vlerave post-materialiste që është një shoqëri aq më tepër ajo

⁴⁰ Artan Fuga, *Rrota e mundimit*, (Dudaj, Tiranë, 2007) f. 17-18.

⁴¹ Afrim Krasniqi, *Partitë Politike në Shqipëri 1920-2006*, (Eurorilindja, Tiranë, 2006) f. 234.

⁴² Ronald Inglehart, “East European value system in global perspective” në *Democracy and Political Culture in Eastern Europe*, redaktuar nga Hans-Dieter Klingemann, Dieter Fuchs, dhe Jan Zielonka, (Routledge, Oxon, 2006)

është e predispozuar të ketë një sistem të qëndrueshëm dhe të shëndoshë demokratik dhe e kundërta, një shoqëri me një profil vlerash materialist (të mbijetesës) ka më shumë gjasa të ketë një nivel të ulët të demokracisë në vend. Duke u mbështetur në studimet e Inglehart dhe në studimet e realizuara nga Aleksandër Kocani mbi profilin e vlerave të Shqipërisë post-komuniste arrijmë në përfundimin se shoqëria shqiptare i përket një sistemi vlerash të profilit materialist⁴³. Shoqëritë me sistem vlerash të profilit materialist janë të orientuara nga qëndrimet pragmatiste, ku arrijtet dhe fitimi i shpejtë janë qëllim në vetvete, ndërkaq vlerat post-materialiste si demokracia, barazia, e drejta e përbashkët nuk janë ende vlera dominante. Ndaj publikja shihet si një projekt në të cilin nuk ka interes për të investuar dhe privatja (vetjakja) është me rëndësi.

Kultura politike shqiptare bazohet në parime autoritariste pasi është mbajtur gjatë sistemit totalitar. Erich Fromm shkruan “autoritaristi e sheh botën dhe marrëdhëniet njerëzore sipas modelit piramidial, hierarkik. Ata që qëndrojnë lart ushtrojnë pushtet dhe ata që janë poshtë i binden pushtetit. Një model i tillë qëpërkrahet nga individi në individ është rrjedhimisht një model shoqëror”⁴⁴. Ndaj, edhe qytetari shqiptar në raport me pushtetin ka një qëndrim nënshtrues, ai e njeh vendin e tij në piramidën e marrëdhënieve njerëzore dhe e pranon atë. Në shoqërinë shqiptare organizimi i jetës shoqërore deri vonë është ndërtuar mbi bazën e strukturave klanore, fisnore dhe patriarkale, ku bindja ndaj të parit të familjes dhe të fisit ishte një ligj shoqëror i padiskutueshëm⁴⁵. Kështu, në strukturën fisnore të shoqërisë shqiptare nuk kishte vend për liri individuale, madje ky koncept nuk ekzistonte, pasi njeriu nuk ekzistonte si një

⁴³ Aleksandër Kocani, *Hulumtimi i sistemit të vlerave në Republikën e Shqipërisë në periudhën postkomuniste*, (AU, Tiranë 2013, f. 43-44)

⁴⁴ Erich Fromm, *Njeriu për vete*, (Phoenix, Tiranë, 2003) f. 52

⁴⁵ Artan Fuga, *Shtige drejt guvës së gjarpërit*, (Ora botime, 2004, Tiranë) f. 86

individ, por shkrihej në homogjenitetin e familjes, fisit. Rrjedhimisht shoqëria shqiptare se pati të vështirë të pranonte vendosjen e një sistemi totalitarist pasi strukturat hiperhomogjene ishin të pranishme dhe bëjnë pjesë në trashëgiminë kulturore të vendit⁴⁶.

Kështu, tiparet autoritariste të shoqërisë shqiptare shihen në trashëgiminë kulturore të vendit dhe në kulturën politike të Shqipërisë post-komuniste. Kultura politike e Shqipërisë u ndërtua gjatë 50 viteve përmes përdorimit të propagandës, shtypit, muzikës, artit, letërsisë, kinematografisë dhe u ruajt e u kultivua përmes organizatave dhe unioneve që ishin zgjatime të Partisë Komuniste. Kjo kulturë politike ekzistuese edhe sot, nuk ka ndryshuar duke e mbajtur peng demokratizimin e vendit. Regjimi komunist ra, por shoqëria shqiptare nuk është ballafaquar me pasojat e regjimit, nuk janë bërë të ditura krimet e regjimit, nuk janë sensibilizuar individët mbi regjimin totalitar dhe pasojat psikologjike, sociale e njerëzore që sistemi ka pasur në shoqëri. Madje, nuk është dënuar askush për krimet e bëra, pra nuk pati një katarsis shoqëror, për të kuptuar faktorët që e sollën totalitarizmin. Nuk u kërkua falje publike mbi diktaturën totalitare, përndjekjen, internimin dhe ekzekutimin e një numri të madh të shqiptarëve: 34.135 ishte numri i të burgosurve politikë në burgjet komuniste, 59.009 ishte numri i të internuarve në kampe përqendrimi⁴⁷. Kjo ishte në përputhje me logjikën “fajtorë janë të gjithë dhe asnjë”, metoda e përdorur prej elitave dhe të penduarve komunistë përballë botës për të dëshmuar që “të gjithë ishin të pafajshëm” ishte krijimi i një personi të ri kolektiv që iu vesh e gjithë përgjegjësia retrospektive e ngjarjeve. Kjo metodë e rishkrimit të së kaluarës ishte një metodë tipike

⁴⁶ Ibid, f. 86

⁴⁷ Marrë nga statistikat e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, (marrë nga :<http://www.iskk.gov.al/>, parë për herë të fundit më 25 prill 2017)

komuniste, siç i referohet Lefort “pranimi i një bashkëfajësie kolektive është një shpifje e stilit ish- komunist”⁴⁸. Si mund t’i “përqafosh” vlerat dhe parimet demokratike, kur nuk je përballur me të kaluarën komuniste? Si mund ta pajtosh logjikën e përjashtimit që mbizotëronte në diktaturën totalitare me logjikën e përfshirjes që mbizotëron në demokraci?

Në mbështetjen e këtij argumentimi citojmë A. Fugën i cili edhe njëherë rithekson idenë e këtij punimi se vendosja e sistemit politik demokratik nuk përkoi me kontekstin shoqëror të duhur, “instalimi i institucioneve demokratike bëhej në kushtet kur totalitarizmi i mëhershëm ishte shndërruar në pengesë për shoqërinë, ishte bërë i tepërt, ndërsa kushtet shoqërore për një demokraci moderne, të menjëhershme, të standardeve të larta, ende nuk ishin të pranishme”⁴⁹. Madje, kushtet për një demokraci cilësore jo vetëm që nuk ishin, por duheshin krijuar⁵⁰, por me udhëheqës politikë të prejardhur nga nomenklatura komuniste, ka qenë e vështirë, për të mos thënë e pamundur që të krijohet një kulturë politike demokratike në vend. Politologu A. Krasniqi vë në dukje pikërisht këtë fenomen, riciklimin e udhëheqësve komunistë dhe antikomunistë me njëri-tjetrin, duke zëvendësuar në mënyrë periodike njëri-tjetrin⁵¹. Pra, në shoqërinë shqiptare post-komuniste ka pasur rotacion politik, por rotacioni politik nuk ka sjell ndryshimin politik të kërkuar për një demokratizim real.

Bindja ndaj pushtetit është një tjetër element i kulturës politike shqiptare. Qytetari shqiptar i është bindur formës së qeverisjes në fazën e tranzicionit edhe pse është i bindur se

⁴⁸ Claude Lefort, *La complicazione: al fondo della questione comunista*, (Eleuthera, Milano, 2000) f. 24.

⁴⁹ Artan Fuga, *Media, Politika, Shoqëria 1990- 2000*, (Dudaj, Tiranë, 2008) f. 467

⁵⁰ Ibid.

⁵¹ Afrim Krasniqi, *Partitë Politike në Shqipëri 1920-2006*, (Eurorilindja, Tiranë, 2006) f. 238-239

pushteti është i korruptuar dhe nuk po punon në interes të vendit. Shqipëria është shteti i fundit që ra regjimi i fundit komunist në Evropë dhe vendosja e pluralizmit politik erdhi si pasojë e një marrëveshjeje/ kompromisi mes PPSH-së dhe PD-së. Madje, edhe pas 27 viteve tranzicion qytetarët shqiptarë kanë perceptimin se institucionet publike nuk mbrojnë interesat publike dhe se janë tepër tëkorruptuara⁵², sikurse i kemi paraqitur në raportet e institucioneve vendore e ndërkombëtare⁵³, por nga ana tjetër ata përsëri i janë bindur pushtetit dhe nuk kanë protestuar apo ngritur zërin në mënyrë paqësore kundër tij. Shoqëria shqiptare është një shoqëri apatike e cila nuk ndjehet për kërkesat e saj për një qeverisje më të mirë, por i bindet pushtetit pa rezerva edhe kur e quan të padrejtë. Pavarësisht pakënaqësisë së artikuluar të qytetarëve shqiptarë ata vazhdojnë të votojnë të njëjtat alternativa politike dhe të njëjtët individë që drejtojnë partitë kryesore dhe vendin. Njëkohësisht, mungesa e formave të ndikimit në sistemin politik si protestat qytetare e paqësore kanë munguar dhe në rastin kur ato mbahen të lidhura me interesa partiake. Në Shqipëri janë të regjistruara 126 parti politike, por elektorati vijon t'i votojë të njëjtat alternativa dhe të njëjtët udhëheqës politik⁵⁴.

Një tjetër element i kulturës politike shqiptare është raporti me liderin karizmatik dhe autoritar. Duke qenë një shoqëri me një kulturë autoritariste (ende me tipare të sistemit totalitar),

⁵² Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), *Sondazhi i opinionit publik-besimi në qeveri* (BE dhe UNDP, Tiranë, dhjetor 2015)

⁵³ Albania corruption rank, marrë nga:

<http://www.tradingeconomics.com/albania/corruption-rank>, parë për herë të fundit më 24 prill 2017 dhe marrë nga:

http://www.transparency.org/ehatëedo/publication/cpi_2015, parë për herë të fundit më 24 prill 2017.

⁵⁴ Afrim Krasniqi, 126 Parti në Shqipëri', (marrë nga

<http://www.citynews.al/2016/05/nga-afirim-krasniqi-126-partite-politike-ne-shqiperi-nevoja-per-reforme-nga-financimi-tek-demokratizimi/1>, parë për herë të fundit më 24 prill 2017)

qytetari shqiptar si një autoritarist që e sheh botën në modelin e një piramide kërkon të krijojë lidhje emocionale, personale me liderin që do të qeverisë vendin. Ndërkaq, profili i liderit në këto 27 vite demokraci është i njëjtë: ai i tipit autoritarist. Është lideri apo udhëheqësi politik ai që ushtron pushtetin dhe kërkon bindje dhe nënshtrim të ethshëm ndaj pushtetit. Lideri politik ka tipare karizmatike dhe i tregon “gjithkujt” vendin që i takon. Ky argument gjen mbështetje në studime dhe autorë të ndryshëm. Në një studim mbi marrëveshjet politike të arritura gjatë tranzicionit në Shqipëri, Instituti i Studimeve Politike arrin në përfundimin se marrëveshjet politike kanë prodhuar udhëheqës të “fortë” dhe institucione të “dobëta”⁵⁵. Në rastet e krizave politike arrijtjet e marrëveshjeve politike kanë ndodhur jashtë institucioneve, sikurse dhe rasti i fundit i bojkotit të deklaruar të zgjedhjeve nga opozita, duke anashkaluar institucionet dhe procedurat e shteteve me demokraci të qëndrueshme. Prej vitit 1992 pushteti i liderëve partiakë jo vetëm që nuk është reduktuar, por është rritur, në mbështetje të këtij konstatimi shohim tabelën me të dhëna, të huazuar nga Instituti i Studimeve Politike (ISP)⁵⁶.

⁵⁵ Instituti i Studimeve Politike: Marrëveshjet politike 1991- 2016: produkti Liderë të fortë dhe institucione të dobëta, (marrë nga : <http://isp.com.al/2016/06/06/marreveshjet-politike-1991-2016-produkti-lidere-te-forte-dhe-institucione-te-dobeta/>, parë për herë të fundit më 24 prill 2017)

⁵⁶ Instituti i Studimeve Politike: Nga kryetarët me dy mandate tek kryetarët e gjithpushtetshëm,(marrë nga : <http://isp.com.al/2017/03/21/isp-rrpp-nga-kryetarët-me-dy-mandate-1992-tek-kryetarët-e-gjithpushtetshëm-2017/>, parë për herë të fundit më 24 prill 2017)

KOMPETENCAT THELBESORE	ISHIN MË 1992	JANË MË 2017
Mandati i Kryetarit	Vetëm dy mandate	Pa përcaktim
Zgjedhja e kryetarit	Me kandidat rival	Pa kandidat rival
Zgjedhja e kryesisë	Nga Kongresi/Kuvendi	Nga Këshilli/Asambleja
Perfaqëson partinë	Kryesia	Kryetari
Zgjedh sekretarin me jashtë	Kryesia	Kryetari
Zgjedh departamentet	Asambleja/Këshilli	Kryetari/kryesia
Propozimi i kryesisë	Nga çdo anëtar ne KK/AK	Nga kryetari
Zgjedhja e Sekretareve	Propozim nga Asambleja	Propozim nga kryetari
Zgjedhja e zv/kryetareve	Propozim nga Asambleja	Propozim nga kryetari
Zgjedhja e zëdhënësit	Emërim nga kryesia	Emërim nga kryetari
Kandidat kryeministër	E zgjedh kryesia	Është kryetari
Kandidat deputet	I zgjedh zona	I zgjedh kryetari
Kandidat ministër	I zgjedh kryesia	I zgjedh kryetari
Kandidat kr. Bashkie	I zgjedh zona	I zgjedh kryetari
Kritiket/fraksion ne parti	Lejohej kritika/fraksioni	Ndalohet kritika/fraksioni
Mbledhje Këshilli/Asambleje	4 mbledhje	0 -1 mbledhje
Konference/Aktiv kombëtar	Çdo dy vjet	Çdo katër vjet
Mocioni i Mosbesimit	Aplikohej mocioni	Nuk aplikohej mocioni
Vendimmarrja në kryesi	Me votim të fshehtë	Me votim të hapur
Kryetar dege - pezullimi	Pezullon kryesia	Pezullon kryetari
Kryesia lokale - pezullimi	Pezullon Asambleja/këshilli	Pezullon kryetari
Anëtar kryesie - pezullimi	Pezullon kryesia	Pezullon kryetari
Deputet - pezullimi	Pezullon kryesia/grupi	Pezullon kryetari
Mbledhje kryesie	18 mbledhje	4-5 mbledhje

Burimi: Instituti i Studimeve Politike. RPPP project "The Presidentialization of political parties"

Figura 1. Kompetencat e kryetarëve partiakë në Shqipëri, 1992-2017⁵⁷

Gjithashtu, funksionimi i koalicioneve midis partive në Shqipërinë post-komuniste nuk bazohet në programet politike dhe orientimet ideologjike e politike, por faktor determinues janë njohjet personale me liderin politik⁵⁸. Gjatë fazës së tranzicionit përvoja ka treguar se emrat dominues që kanë udhëhequr Shqipërinë post-komuniste janë individë me karakter të fortë dhe nivel të lartë të autoritarizmit. Madje, përfshirja në politike e figurave të moderuara nga pikëpamja politike ka sjellë ose ndryshimin e tyre duke e përngjarë dhe imituar liderin historik të partisë ose janë mënjeluar nga skena politike. Në mbështetje të kësaj ideje studiuës të ndryshëm kanë bërë shpesh analogjizma midis modelit stalinist dhe modelit shqiptar të partive politike, “në të njëjtën mënyrë, edhe partitë post-

⁵⁷ Ibid

⁵⁸ Afrim Krasniqi, *Partitë Politike në Shqipëri 1920-2006* (Tiranë: Eurorilindja , 2006), f..245

komuniste në Shqipëri dhe në disa vende të tjera u krijuan në frymë fetare: ato kishin një lider shpirtëror (udhëheqësin)⁵⁹. Tek sistemi politik dhe partitë politike në Shqipërinë gjatë 27 viteve tranzicion kanë ndodhur mjaft ndryshime, por nga këto ndryshime nuk janë prekur udhëheqësit historik të partive⁶⁰.

Përfundime

Në këtë studim analizuam rolin e kulturës politike në proceset e demokratizimit duke pasur si rast studimor Shqipërinë post-komuniste. Teza kryesore e këtij punimi ishte mungesa e kongruencës midis kulturës politike dhe sistemit politik demokratik në Shqipëri gjatë tranzicionit. Ndonëse theksuam konceptet kryesore teorike dhe filozofike mbi nocionin e kulturës politike si faktordeterminues në krijimin e një sistemi politik e demokratik të qëndrueshëm dolëm në konkluzionin që në shoqërinë shqiptare post-komuniste kjo gjë ende nuk është arritur. Kultura politike e Shqipërisë post-komuniste nuk është shkëputur nga sistemi totalitar pasi kushtet shoqërore për ndërtimin e një demokracie të qëndrueshme e të menjëhershme nuk ishin, madje duheshin krijuar. Edhe elitat politike kanë dështuar në nxitjene kushtesive agjentë socializues të proceseve politike për të krijuar një kulturë politike demokratike në vend.

Pjesa e parë e punimit është e përqendruar në aspektet teorike dhe filozofike të kulturës politike. Po ashtu, është dhënë një kuadër i shkurtër i ndikimit të diktaturës komuniste në krijimin e kulturës politike gjatë totalitarizmit. Në të njëjtën kohë jepet një përshkrim dhe shpjegim i aspekteve të kulturës politike dhe marrëdhënies së saj me sistemet politike. Në pjesën e dytë të

⁵⁹ Ibid, f. 246-247

⁶⁰ Ibid, 260

punimit janë evidentuar tiparet e tranzicionit në Shqipëri duke argumentuar se kultura politike nuk mbështet demokratizimin në vend, pasi që është mbetje e regjimit të kaluar. Ende pas 27 viteve tranzicioni social, kulturor e ekonomik është i papërfunduar dhe Shqipëria renditet si një semi-demokraci (shih raportet e Freedom House mbi demokracinë në botë)⁶¹. Kultura politike totalitare, jodemokratike e ndërtuar gjatë pesë dekadave të regjimit totalitar shqiptar është bërë frenuese dhe penguese e demokracisë në vend. Për këtë arsye, nevojiten studime të mirëfillta mbi ndërtimin e një kulture politike demokratike në vend. Kur flasim për kulturë politike, demokratike kemi parasysh subjektin më të rëndësishëm politik në shoqëri: qytetarin pjesëmarrës. Nuk mund të ndërtohet demokracia në vende dhe shoqëri ku qytetari nuk disponon vlerat bazike të demokracisë dhe ku qëndrimet ndaj sistemit politik dhe shoqërisë janë në kundërshtim me kuptimin që ka demokracia.

Nga ky studim, mund të arrijmë në përfundimin se është e rëndësishme të krijohen kushtet dhe instrumentet për ndërtimin e një kulturë politike demokratike në vend . Njohja e kulturës politike shpjegon mjaft mbi natyrën e sistemit politik, elitat politike dhe qytetarin në atë shoqëri. Komponentët e kulturës politike në Shqipërinë e post-komunizmit “flasim” për një orientim ndaj sistemit diktatorial totalitar, regjimi ka rënë por mentaliteti është ekzistues. Largimi i elitave politike të cilat janë të lidhura apo kanë prejardhjen nga klasa komuniste dhe zëvendësimi i tyre me elita të reja mund të sjellë ndryshime pozitive duke realizuar një rotacion të vërtetë politik. Duke e orientuar shoqërinë shqiptare kështu drejt një kulture politike konform vlerave, besimeve dhe qëndrimeve të shteteve të konsoliduara demokratike. Brezat e rinj janë ata tek të cilët

⁶¹ Freedom House (marrë nga : <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2016/albania>, parë për herë të fundit më 25 prill 2017)

komponentët totalitarë të kulturës politike do të zhduken duke promovuar dhe ruajtur një kulturë politike demokratike.

Bibliografia

Almond, Gabriel. "Comparative political systems". *Journal of Politics*, vol. 18, no. 3, August 1956.

Almond, Gabriel & Verba, Sidney. *The civic culture*. Princeton: Princeton University Press, 1963.

Arendt, Hannah. *Origjina e totalitarizmit*. Prishtinë: DiJa, 2002.

De Tokvilë, Aleksis. *Mbi demokracinë në Amerikë*, Pejë: Dukagjini, 1998.

McLean Ian & McMillan, Alex, *Oxford- Concise dictionary of politics*. Oxford: Oxford University Press, 2009.

Mayer. C. Laurence. *Politikat Krahasese*. Tiranë: Ora Botime, 2003.

Eckstein, Herry. "A theory of stable democracy", në *Divisions and Cohesion in democracy : A study of Norway* dhe Eckstein, Herry "Authority relations and government performance : A theoretical Framework," *Comparative Political Studies*, vëllimi 2, nr.3 (269-362), cituar në Laurence C. Mayer et.al, *Politikat krahasese*. Tiranë: Ora Botime, 2003.

Inglehart, Ronald. "East European value system in global prespective". *Democracy and Political Culture in Eastern Europe*, redaktuar nga Klingemann Dieter-Hans, Fuchs, Dieder dhe Zielonka, Jan. Routledge: Oxon, 2006.

Ronald Inglehart dhe Christian Welzel, *Modernization, cultural change and democracy : The human development sequence*, New York: Cambridge University Press, 2005.

Tomash, Gashpar, Feher, Ferenc dhe Heler, Agnesh. *Filozofia dhe tranzicioni*. Tiranë: Arbri, 1989.

Kocani, Aleksandër. *Hulumtimi i sistemit të vlerave në Republikën e Shqipërisë në periudhën postkomuniste*. Tiranë: AU, 2013.

Fuga, Artan. *Rrota e mundimit*. Tiranë: Dudaj, 2007.

Krasniqi, Afrim. *Partitë Politike në Shqipëri (1920-2006)*. Tiranë: Eurorilindja, 2006.

Fromm, Erich. *Arratisje nga liria*, Tiranë: Plejad. 2011.

Fromm, Erich. *Njeriu për vete*. Tiranë: Phoenix, 2003.

Fuga, Artan. *Shtige drejt guvës së gjarpërit*. Tiranë: Ora botime, 2004.

Lefort, Claude. *La complicazione: al fondo della questione comunista*. Milano: Eleuthera, 2000.

Lefort, Claude. *The political forms of modern society*, Cambridge, Massachusetts: MIT Press, 1986.

Fuga, Artan. *Media. Politika, Shoqëria, 1990-2000*. Tiranë: Dudaj, 2008.

Raporte dhe dokumente

Freedom House, Nations in transit – Albania, (marrë nga: <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2016/albania>, parë për herë të fundit më 25 prill 2017).

Albania corruption rank , marrë nga : <http://www.tradingeconomics.com/albania/corruption-rank>, parë për herë të fundit më 24 prill 2017 dhe marrë nga: http://www.transparency.org/whatwedo/publication/cpi_2015, parë për herë të fundit më 24 prill 2017.

Krasniqi, Afrim. '126 Parti në Shqipëri', (marrë nga: <http://www.citynews.al/2016/05/nga-afrim-krasniqi-126-partite-politike-ne-shqiperi-nevoja-per-reforme-nga-financimitek-demokratizimi/1>, parë për herë të fundit më 24 prill 2017).

Instituti i Studimeve Politike, “Marrëveshjet politike 1991-2016: produkti? Liderë të fortë dhe institucione të dobëta” , (marrë nga : <http://isp.com.al/2016/06/06/marreveshjet-politike-1991-2016-produkti-lidere-te-for-te-dhe-institucione-te-dobeta/>, parë për herë të fundit më 24 prill 2017).

Instituti i Studimeve Politike, “Nga kryetarët me dy mandate tek kryetarët e gjithpushtetshëm” ,(marrë nga : <http://isp.com.al/2017/03/21/isp-rrpp-nga-kryetaret-me-dy-mandate-1992-tek-kryetaret-e-gjithpushtetshem-2017/>, parë për herë të fundit më 24 prill 2017).

Statistikat e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, (marrë nga : <http://www.iskk.gov.al/>, parë për herë të fundit më 25 prill 2017).

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Analizë e angazhimit politik në Shqipëri- 2016, (marrë nga: [https://www.ndi.org/sites/default/files/IDM%20Audit%20of%20Political%20Engagement%20\(Shqip\).pdf](https://www.ndi.org/sites/default/files/IDM%20Audit%20of%20Political%20Engagement%20(Shqip).pdf), parë për herë të fundit më 24 prill 2017).

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Sondazhi i opinionit publik- besimi në qeveri. Tiranë: BE dhe UNDP, 2015.

Periudha Komuniste, mësim në gjimnaze, (marrë nga: <http://www.standard.al/2016/12/15/periudha-komuniste-mesim-ne-gjimnaze-agron-tufa-nuk-do-bejme-propagande/>, parë për herë të fundit më 24 prill 2017).

